

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Tonka Berishaj, kryetare, Fillim Skoro, gjyqtar raportues e Xhevdet Abazi, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Përparim Zeka, si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarve A.N. e B.N., për shkak të veprës penale të kryer në bashkëkryerje lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe N.N., për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.2 dhe par.1 pika 4 të KPRK, duke vendosur përkritazi me ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar E.N. dhe E.N.2, av.M.N. dhe mbrojtëve të të akuzuarve A.N., av.N.Sh., B.N., av.S.M. dhe N.N., av.A.B., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.334/2017, të dt.26.12.2017, ne seancën publike të kolegjit të mbajtur, me dt.01.03.2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohen si të pabazuara ankesat e përfaqësuesit të palës së dëmtuar E.N. dhe të dëmtuarit E.N.2, si dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve A.N., B.N. e N.N., dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.334/2017, të dt.26.12.2017, vërtetohet.

Arsyetim

Gjykata Themelore-DKR, në Prishtinë, me aktgjykimin e saj, PKR.nr.334/2017, të dt.26.12.2017, i ka shpallur fajtor të akuzuarit A.N. e B.N., për veprën penale të kryer në bashkëkryerje lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe N.N., për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.2 dhe par.1 pika 4 të KPRK.

Të akuzuarit A.N. ia shqipton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 2(dy)vite, të cilin do ta mbaj pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në dënimin e shqiptuar me burgi i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.16.08.2017 e deri në plotëfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit B.N., ia shqipton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 2(dy)viteve, të cilin do ta mbaj pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në dënimin e shqiptuar me burgi i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.16.08.2017, e deri në plotëfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit N.N., i shqipton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 1(një)viti, të cilin do ta mbaj pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në dënimin e shqiptuar me burgi i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga dt.16.08.2017, deri me dt.26.12.2017.

Të dëmtuari E.N. dhe E.N.2, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Të akuzuarit A.N., B.N. dhe N.N., janë të obliguar që secili veç e veç ti pagajën shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës dhe secili është i obliguar të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 100Euro, në afat prej 15 ditëve, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi me kohë ka ushtruar ankesë:

-Përfaqësuesi i palës së dëmtuar av.M.N., për të dëmtuarin E.N., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal dhe ka propozuar që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarve A.N., E.N., E.N.i dhe B.N., ti shqiptoj dënime më të rënda.

-I dëmtuari E.N.2, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal dhe ka propozuar që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarve A.N., B.N., dhe N.N., ti shqiptoj dënime më të rënda.

-Mbrojtësi i të akuzuarit A.N., av.N.Sh., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarit ti shqiptoj dënim më të butë, siç parashihet me dispozitat e nenit 75 dhe 76 par.1 nën par.1.3 të KPK.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.N., av.S.M., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit ti shqiptoj dënim më të butë në kuptim të dispozitës së nenit 75 dhe 76 par.1 nën par.1.3 të KPK.

-Mbrojtësi i të akuzuarit N.N., av. A.B., për shkak të vendimit mbi dënimin me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarit ti shqiptoj dënim më të butë.

Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj, PPA/I.nr.86/2018, të dt.09.02.2018, duke u sqaruar përkritazi me ankesën e përfaqësuesit të palëve të dëmtuara Ujup dhe E.N.2, ka propozuar që të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të akuzuarve për veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor t'iu shqipton dënime më të larta, ndërsa të refuzohet si të pabazuara ankesat e të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre A.N., B.N. dhe N.N., avokatëve N.Sh., S.M. dhe A.B..

Gjykata e Apelit, caktoi seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën të nenit 390 të KPP, ku morën pjesë të dëmtuari E.N.i dhe përfaqësuesi i tij, av.M.N. i dëmtuari E.N.2, të akuzuarit A.N., B.N. dhe mbrojtësit e tyre av. N.Sh., S.M. dhe A.B., ndërsa ka munguar i akuzuari N.N., për të cilin mbrojtësi i tij ka deklaruar se është njoftuar në mënyrë të rregullt dhe seanca e kolegjit është mbajtur në mungesë të tij, për arsye se pjesëmarrja e tij nuk është e domosdoshme.

Gjykata e Apelit, konformë nenit 394 par.1 të KPP, vlerësoi ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar E.N., av.M.N. dhe të dëmtuarit E.N.2, si dhe aneksat e mbrojtësve të akuzuarve A.N., B.N. dhe N.N., av.N.Sh., av.S.M. dhe av.A.B., e duke marrë parasysh edhe sqarimin me shkrim të Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se:

Ankesat e përfaqësuesit të palës së dëmtuar E.N., të dëmtuarit E.N.2 dhe të mbrojtësve të akuzuarve A.N., B.N. dhe N.N., janë të pabazuara.

Pretendimet ankimore të paraqitura dhe gjetjet e gjykatës.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar E.N.i dhe i dëmtuari E.N.2, të cilat ankesa përkrah përmbajtja janë identike, pretendojnë se të akuzuarve A.N., B.N., dënimet e shqiptuara me burgim secilit prej nga 2(dy)vite janë të buta dhe dënimet nuk i përgjigjen peshës së veprës penale, po ashtu edhe dënimi i shqiptuar të akuzuarit N.N., në kohëzgjatje prej 1(një)viti, është dënim i ulët duke marrë parasysh se i akuzuari N.N., është kryes i shumë veprave penale dhe dyshohet për vepra tjera penale, që të akuzuarit kanë përdorë mjete të rrezikshme dhe të përshtatshme për shkaktimin e lëndimeve dhe gjykata nuk i ka vlerësuar drejt pasojat e mëdha të cilat u janë shkaktuar të dëmtuarve.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.N.t, av.N.Sh., në ankesën e tij pretendon se gjykata me rastin e caktimit të dënimit gjykata ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese me rastin e caktimit të dënimit, mirëpo, nuk ka analizuar mjaftueshëm rrethanat posaçërisht lehtësuese në mënyrë meritore siç parasheh dispozita e nenit 75 par.1 nën par.1.2 që të akuzuarit tis shqiptohet një dënim më i butë, kjo për arsye se më parë nuk ka qenë i dënuar, se pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe ka shpreh keqardhje ndaj të dëmtuarve dhe menjëherë pas ngjarjes të ndodhur ka kërkuar falje prej palës së dëmtuar E.N.it, përmes të afërmeve të tyre, si dhe i njëjti është babë i pesë fëmijëve dhe është mbajtës i familjes.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.N., av.S.M., në ankesën e tij pretendon se i mbrojturi i tij ka kërkuar falje pranë gjykatës nga pala e dëmtuar dhe ka premtuar se nuk do të kryej vepra tjera penale dhe gjykata nuk ka analizuar në mënyrë të drejtë rrethanat lehtësuese, në mënyrë meritore dhe mbrojtja konsideron se ka pasur hapësirë dhe mundësi që ti shqiptohet një dënim më i butë, në pajtim me nenin 75 par.1 nën par.1.2 të KPRK, duke marrë parasysh pranimin e fajit, keqardhjen e shfaqur të akuzuarit dhe se i akuzuari B.N., pas konfliktit menjëherë ka dërguar të afërmit ti kërkoj falje të dëmtuari E.N.i, se i njëjti është mbajtës i familjes, babë i katër fëmijëve dhe të njëjtin burim të jetesës e kanë shijten e drunjve.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.N., av.A.B., në ankesën e tij pretendon se në aktgjykim nuk janë dhënë arsyet bindëse lidhur me vendimin mbi dënimin, kur dihet se dënimi është pjesa më e rëndësishme e aktgjykimit, gjykata as nuk i ka numëruar e as vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe gjykata si rrethanë lehtësuese ka marrë vetëm pranimin e fajësisë, ankesa pretendon se me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, duhet të arrihen efektet pozitive të i akuzuari që paraprakisht duhet ekzaminuar personalitetin dhe karakterin e të akuzuarit dhe pikëpamjet kryesore të tij, gjë që gjykata nuk ka dhënë në një përpjekje për të marrë një vendimi të drejtë lidhur me vendimin mbi dënimin, duke pasur parasysh se i akuzuari është i moshës së re, person familjar dhe ka pranuar fajësinë.

Gjykata e Apelit, në pajtim me nenin 394 par.1 të KPP, duke e vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar E.N.i dhe të dëmtuarit E.N.2, si dhe të ankesave të mbrojtësve të akuzuarve A.N., B.N. e N.N., e duke vepruar sipas detyrës zyrtare në kuptim të ekzistimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1, dhe të shkeljes së ligjit penal, nga neni 385 par.1 të KPP, Gjykata e Apelit, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është përfshirë në shkeljet e cekura më lartë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Gjykata e Apelit, vlerësoi pretendimet ankimore të përfaqësuesit të palës së dëmtuar E.N.i, dhe të dëmtuarit E.N.2, si dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve A.N., B.N. e N.N., dhe ka ardhë në përfundim se në ankesat e palëve të dëmtuara nuk janë paraqitur rrethana posaçërisht rënduese, të cilat kishin me ndikuar në ashpërsimin e dënimit, e po ashtu edhe në ankesat e mbrojtësve të akuzuarve nuk janë paraqitur rrethana posaçërisht lehtësuese e që kishin me ndikuar në zbutjen e dënimit. Gjykata e shkallës

së parë, me rastin e marrjes dhe matjes së dënimit, ka marrë parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, të paraparë si në nenin 73 të KPRK-së, si dhe rregullat e përgjithshme për zbutjen apo ashpërsimin e dënimit të paraparë si në nenin 74 të KPRK dhe gjykata, drejtë ka vlerësuar rrethanat lehtësuese, se të akuzuarit A.N., B.N. e N.N., kanë pranuar fajësinë, se janë penduar dhe kanë shprehur keqardhje për veprat penale të kryera, si dhe kanë vlerësuar edhe rrethanat tjera të cekura në ankesat e mbrojtësve të akuzuarve, se të akuzuarit B.N. dhe N.N., janë shpallur fajtor me aktgjykime të plotfuqishme, të cilat janë paraqitur edhe në ankesat e të dëmtuarve, e të cilat si të vërtetuara i merr edhe Gjykata e Apelit, dhe të mbrojtësve të akuzuarve.

Në mungesë të rrethanave tjera posaçërisht rënduese të palëve të dëmtuara të cilat nuk janë paraqitur në ankesa dhe në mungesë të rrethanave posaçërisht lehtësuese të mbrojtësve të abuzuarve, të cilët nuk janë paraqitur në ankesa e tyre , e duke marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, e në kuadër të vlerësimit të rrethanave të cekura më lartë, gjykata drejt ka aplikuar nenin 76 par.1 nën par.1.3 të KPRK dhe të akuzuarve iu A.N. dhe B.N., secilit veç e veç iu ka shqiptua dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 2(dy)vite, të cilat dënime janë nën minimumin e paraparë ligjor, ndërsa të akuzuarit N.N., i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti, dhe dënimet e shqiptuara të akuzuarve nga ana e gjykatës së shkallës së parë, janë në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale dhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit me dënimin e këtille të shqiptuara me burgim ndaj të akuzuarve, pritet të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë si në nenin 41 të KPRK.

Si u cekë edhe më lartë u vendos si që ankesat e përfaqësuesit të palës së dëmtuar E.N.i dhe të dëmtuarit E.N.2, si dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve, janë refuzohen si të pabazuara dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPRK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.53/2018, me dt.01.03.2018

Procesmbajtës,

Përparim Zeka

Anëtarët e Kolegjit

Fillim Skoro

Xhevdet Abazi

Kryetare e Kolegjit

Tonka Berishaj